

IKD-ja dhe GLPS-ja: Qeveria në detyrë po vepron në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTI KËRKON MARRËVESHJE PËR PRESIDENTIN, OPOZITA E AKUZON PËR BLLOKADË DHE SHKELJE TË KUSHTETUTËS

FAQE 4-5



Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka kërkuar nga partitë politike t'i nisin diskutimet për emrat konkretë të kandidatëve për president, me synim arritjen e një marrëveshjeje dhe shmangien e zgjedhjeve të reja.

Ndërkohë, PDK-ja dhe AAK-ja kanë kërkuar vazhdimin e seancës konstituive, duke e akuzuar pushtetin për shkelje të Kushtetutës dhe krijim të vakuumit institucional. PDK-ja, përmes Bedri Hamzës, ka thënë se

pas qëndrimit të LDK-së, LV-ja i ka numrat për konstituimin e Kuvendit. LDK-ja, ndërkaq, ka hequr dorë nga kërkesat për poste institucionale dhe ka kërkuar që presidenti i ardhshëm të jetë figurë jopartiake dhe konsensuale

HARADINAJ PARALAJMËRON PROTESTA DHE BLLOKADA: DO TË JENË PËRGJIGJJA NDAJ KURTIT

F. 5



A MUND TA ZHBLLOKOJË KUSHTETUESJA NGËRÇIN NË KUVEND?

F. 5



MAQEDONCI: KOSOVA E GATSHME T'I NDIHMOJË SHQIPËRINË DHE MALIN E ZI PËR SHUARJEN E ZJARREVE

F. 3

100 KADETË BËHEN PJESË E SHËRBIMIT KORREKTUES TË KOSOVËS

F. 7

PROKURORI KODRALIU: I DYSHUARI PRANOI SE ISHTE REKRUTUAR NGA BIA DHE KISHTE KONTAKTE TË VAZHUESHME ME ZYRTARËT SERBË

F. 7

EKONOMI



NDËRMARRJA
PUBLIKE
BANESORE

PËRMARUESI BLLOKON LLOGARITË E NPB-së, NDËRMARRJA PARALAJMËRON PASOJA TË RËNDA FINANCIARE

F. 8

IKD-ja: MOSKONSTITUIMI I KUVENDIT RREZIKON 31.3 MILIONË EURO NGA PLANI I RRRITJES SË BE-së

F. 8

SPORT



FELIX MAGATH VIZITON FFK-në, TAKOHET ME AGIM ADEMIN

F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +387 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Maqedonci: Kosova e gatshme t'i ndihmojë Shqipërinë dhe Malin e Zi për zjarret

PRISHTINË, 14 GUSHT - Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka bërë me dije se Kosova është e gatshme t'u ofrojë ndihmë Shqipërisë dhe Malit të Zi, të cilat po përballen me zjarre në zona të ndryshme. Maqedonci ka thënë se homologëve të tij nga Shqipëria dhe Mali i Zi ua ka përcjellë gatishmërinë e Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës për të ofruar

mbështetje me kapacitetet që vendi ka në dispozicion. Sipas tij, Kosova është e gatshme të kontribuojë në përballimin e situatës nëse autoritetet e dy vendeve vlerësojnë se ndihma është e nevojshme.

“Kosova është e gatshme të kontribuojë në mbështetje të autoriteteve përkatëse, nëse një ndihmë e tillë vlerësohet e nevojshme, duke vënë në dispozicion kapacitetet tona

për përballimin e situatës së krijuar nga zjarret. Në momente të tilla solidariteti dhe bashkëpunimi marrin një rëndësi të veçantë. Ministria e Mbrojtjes, Forca e Sigurisë së Kosovës dhe institucionet e tjera të Republikës mbeten të gatshme të ofrojnë mbështetje dhe të kontribuojnë aty ku kapacitetet tona mund të jenë të dobishme”, ka thënë Maqedonci.



HEGSETH: SHBA-ja MUND TA MBAJË BLLOKADËN DETARE NDAJ IRANIT PËR AQ KOHË SA TË JETË E NEVOJSHME



UASHINGTON, 14 GUSHT - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, ka thënë se Shtetet e Bashkuara kanë kapacitete dhe burime të nevojshme për ta mbajtur bllokadën detare ndaj porteve iraniane për aq kohë sa të jetë e nevojshme. “Marina e Shteteve të Bashkuara mund ta mbajë bllokadën për një kohë të pacaktuar”, ka thënë Hegseth për gazetarët, pasi i është drejtuar ekuipazhit të aeroplanmbajtësit “USS Gridley” gjatë stërvitjeve

ushtarake shumëkombëshe “PANAMAX 2026” në Panama. Aeroplanmbajtësi “Gridley” ishte dislokuar më herët në Lindjen e Mesme. Hegseth ka thënë se ShBA-ja mund ta vazhdojë bllokadën duke zëvendësuar anijet që hyjnë dhe dalin nga zona dhe duke dislokuar forca të reja sipas nevojës. Deklaratat e tij kanë ardhur në kohën kur Uashingtoni dhe Teherani po përplasen lidhur me kontrollin e Ngushticës së Hormuzit, një rrugë ujore

strategjike për transportin global të energjisë.

Para fillimit të luftës mes ShBA-së dhe Iranit në fund të shkurtit, nëpër Ngushticën e Hormuzit kalonte rreth një e pesta e furnizimeve globale me naftë dhe gaz.

Presidenti amerikan Donald Trump ka insistuar se ShBA-ja e kontrollon ngushticën. Megjithatë, zyrtarët ushtarakë iraniane e kanë kundërshtuar këtë pretendim, duke thënë se Teherani vazhdon ta ketë kontrollin mbi rrugën ujore dhe të

ZELENSKY KËRKON 5 PËR QIND TË REZERVËS AMERIKANE TË RAKETAVE “PATRIOT”

KIEV, 14 GUSHT - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky i ka kërkuar Shteteve të Bashkuara t'i shesin Ukrainës 5 për qind të rezervës së tyre të raketave interceptuese për sistemet “Patriot”, duke argumentuar se kjo do ta ndihmonte vendin t'i përballonte sulmet ajrore ruse gjatë dimrit. “Nëse



amerikanët na shesin 5 për qind raketa interceptuese ‘PAC-3’ dhe asgjë tjetër, ne do ta përballojmë dimrin dhe do të shpëtojmë jetë”, ka shkruar Zelensky në “Telegram”. Sipas tij, deri tani Ukrainës i është vënë në dispozicion vetëm rreth 1 për qind e rezervës amerikane të këtyre raketave. Zelensky ka

thënë se nëse ShBA-ja do t'i siguronte Ukrainës 10 për qind të rezervave, forcat ukrainase do të ishin në gjendje t'i asgjësonin raketat balistike ruse. Presidenti ukrainas ka paralajmëruar vazhdimisht për vështirësitë e Ukrainës në mbrojtjen e qyteteve dhe infrastrukturës nga shtimi i

sulmeve ruse me raketa. Sipas Zelenskyt, Ukraina këtë vit ka dy herë e gjysmë më pak raketa interceptuese sesa në vitin 2025, ndërsa Rusia ka rritur prodhimin e raketave balistike dhe po shfrytëzon dobësimin e mbrojtjes ajrore ukrainase për të shtuar përdorimin e tyre.

RUMANIA NDAL ‘REAKTORIN 2’ TË CENTRALIT BËRTHAMOR PËR SHKAK TË NIVELIT TË ULËT TË DANUBIT

BUKURESH, 14 GUSHT - Rumania ka ndaluar për rreth katër orë funksionimin e “Reaktorit 2” në centralin bërthamor të Çernavodës për shkak të rënies së nivelit të ujit në lumin Danub. Centrali siguron rreth 20 për qind të prodhimit të energjisë elektrike në vend. Mbyllja e reaktorit ka rritur presionin mbi sistemin energjetik rumun, në një kohë kur vala e të nxehtit ka shtuar konsumin e energjisë, ndërsa thatësira ka ulur prodhimin nga hidrocentralet. Sipas ekspertëve, situata mund të mbetet e ndjeshme edhe gjatë

ditëve në vijim, pasi niveli i Danubit pritet të mbetet nën kufirin minimal të nevojshëm për funksionimin e “Reaktorit 2”.

Gazetari i “Euronews Romania”, Gabriel Balashu, e ka krahasuar situatën me vitin 2003, kur njëسيا 1 ishte ndaluar për rreth 25 ditë për shkak të një thatësire ekstreme.

Drejtori i centralit bërthamor të Çernavodës, Romeo Urjan, ka thënë se nuk ka rrezik për sigurinë bërthamore, por ka paralajmëruar se niveli shumë i ulët i ujit mund t'i dëmtojë pompat e mëdha të ftohjes. Sipas tij, në rast

dëmtimi, riparimi i tyre mund të zgjasë nga gjashtë muaj deri në një vit. Ekspertët kanë paralajmëruar se ndërprerja e prodhimit nga Çernavoda mund ta detyrojë Rumaninë t'i rrisë importet e energjisë elektrike, duke rritur kostot për konsumatorët. Gjatë ditëve në vijim Rumania pritet të mbështetet më shumë në prodhimin e energjisë nga era dhe në importet e energjisë elektrike. Autoritetet nuk kanë përjashtuar mundësinë e kufizimeve të përkohshme të furnizimit për konsumatorët e mëdhenj industrialë gjatë orëve të pikut.



SHBA DHE BE-JA 'PËRPLASEN' PËR NDIKIMIN NË BALLKAN, KOSOVA MBETET NË QENDËR TË ZHVILLIMEVE

PRISHTINË, 14 GUSHT - Konsensusi perëndimor për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor po zbehet, ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) po ndjekin qasje gjithnjë e më të ndryshme për sigurinë, ekonominë dhe ndikimin politik në rajon. Sipas një analize të publikuar nga "Deutsche Welle", kjo përplasje po shfaqet në mënyrë të veçantë në Bosnjë-Hercegovinë, por mund të ketë pasoja edhe për Kosovën dhe Serbinë, veçanërisht në çështjet që lidhen me kufijtë, sigurinë dhe zhvillimet ekonomike. Për vite me radhë ShBA-ja dhe BE-ja kanë bashkëpunuar në mbështetje të integritetit të Ballkanit Perëndimor në strukturat euroatlantike. Megjithatë, qasja e administratës së presidentit amerikan, Donald Trump po shihet si më e orientuar drejt interesave të sigurisë dhe ekonomisë, ndërsa BE-ja vazhdon të theksojë sundimin e ligjit, reformat dhe perspektivën e anëtarësimit. Ballkani Perëndimor përfshin Shqipërinë, Kosovën, Serbinë, Bosnjë-Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi. BE-ja vazhdon të deklarojë se këto vende kanë perspektivë për anëtarësim, por procesi është ngadalësuar për shkak të reformave të papërfunduara dhe mosmarrëveshjeve politike në rajon.

Përplasja ShBA-BE në Bosnjë-Hercegovinë

Një nga pikat kryesore të dallimeve mes Uashingtonit dhe Brukselit është roli i përfaqësuesit të lartë në Bosnjë-Hercegovinë, një institucion i krijuar pas marrëveshjes së Dejtonit të vitit 1995. Administrata Trump synon kufizimin e kompetencave të përfaqësuesit



të lartë, ndërsa BE-ja vazhdon ta konsiderojë të rëndësishëm rolin e tij për ruajtjen e stabilitetit politik në vend. Sipas ekspertit të Grupit Ndërkombëtar të Krizave, Marko Prelec, qëndrimi amerikan është i arsyeshëm, pasi, 30 vjet pas përfundimit të luftës, është e vështirë të arsyetohet ekzistenca e një zyrtari ndërkombëtar me kompetenca kaq të mëdha në një shtet sovran. Çështja është bërë edhe pjesë e përplasjeve gjeopolitike në rajon. Rusia dhe lideri serb i Bosnjës, Milorad Dodik, kanë kundërshtuar rolin e Përfaqësuesit të Lartë. Dodiku ka promovuar në vazhdimësi idenë e shkëputjes së Republikës Srpska nga Bosnjë-Hercegovina dhe bashkimit të saj me Serbinë. Sipas analizës, ndryshimi i qasjes amerikane ndaj Dodikut ka shkaktuar shqetësim në BE, pasi ekziston frika se një qasje më tolerante ndaj kërkesave për ndryshim kufijsh mund të krijojë precedent edhe për aktorë të tjerë në rajon.

Kosova dhe rreziku i ndryshimit të kufijve

Eksperti Marko Prelec ka

paralajmëruar se mënyra se si mund të përfundojë lufta në Ukrainë mund të ndikojë edhe në Ballkan. Nëse fuqitë perëndimore do të pranonin ndryshime territoriale të realizuara me forcë, sipas tij, aktorë në rajon mund të kërkonin trajtim të ngjashëm. Në këtë skenar, Serbia mund ta përdorte si argument çështjen e Kosovës, ndërsa serbët e Bosnjë-Hercegovinës mund të kërkonin shkëputjen nga shteti boshnjak. Kjo e bën Kosovën një nga çështjet që mund të ndikohet nga ndryshimi i balancave në marrëdhëniet ShBA-BE dhe nga qasja e re amerikane ndaj Ballkanit.

Ekonomia dhe energjia në qendër të interesit amerikan

Përveç sigurisë, ShBA-ja po e vendos ekonominë dhe energjinë në qendër të politikës së saj në Ballkan. Një nga projektet kryesore është eksporti i gazit të lëngshëm natyror drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat tradicionalisht kanë qenë të varura nga furnizimet ruse. Në Kroaci është ankoruar një

terminal lundrues i gazit të lëngshëm natyror, nga ku ShBA-ja synon të zgjerojë furnizimin me energji në rajon. Sekretari amerikan i Energjisë, Chris Wright, i ka cilësuar këto projekte si "tubacionet e paqes" të administratës Trump. Një tjetër projekt i rëndësishëm është "Ndërlidhësi Jugor", i cili synon transportimin e gazit nga Kroacia përmes Bosnjë-Hercegovinës drejt Serbisë. Megjithatë, mënyra se si po zhvillohen disa prej këtyre projekteve ka ngjallur kritika nga organizatat për transparencë dhe ekspertët e rajonit, të cilët kanë ngritur shqetësime për mungesën e konkurrencës dhe respektimin e sundimit të ligjit.

BE-ja përballet me sfidën e humbjes së ndikimit

BE-ja vazhdon të jetë investitori më i madh në Ballkanin Perëndimor, ndërsa më shumë se gjysma e investimeve të huaja në rajon vijnë nga vendet e Bashkimit Evropian. Në të kundërt, pjesa e investimeve amerikane është dukshëm më e vogël.

Megjithatë, ShBA-ja mund të fitojë ndikim përmes projekteve të mëdha infrastrukturore dhe energjetike. Sipas ekspertëve të cituar nga "DW", BE-ja nuk ka arritur të ofrojë projekte të përmasave të ngjashme që qytetarët e rajonit t'i shohin si dëshmi konkrete të përfitimeve nga afrimi me Bashkimin Evropian. Në këtë situatë, edhe perspektiva e anëtarësimit në BE po humb besueshmërinë. Prelec ka vlerësuar se vendet e Ballkanit Perëndimor kanë dëgjuar për integrimin evropian prej dekadash, ndërsa që nga anëtarësimi i Kroacisë në vitin 2013 asnjë shtet tjetër i rajonit nuk është bërë anëtar i BE-së. Mali i Zi mund të jetë vendi i parë që e thyen këtë periudhë të gjatë pritjeje, pasi synon të përfundojë negociatat dhe të anëtarësohet në vitin 2028. Franca dhe Gjermania kanë kërkuar ndërkohë një qasje më fleksibile ndaj vendeve kandidate, duke propozuar që ato të kenë qasje më të hershme në programet dhe tregjet e BE-së edhe para anëtarësimit të plotë.

Në fund, analiza vlerëson se rritja e interesit dhe investimeve amerikane mund të jetë pozitive për ekonominë e Ballkanit Perëndimor, por përplasja mes Uashingtonit dhe Brukselit mund të sjellë edhe rreziqe për stabilitetin politik. Nëse ShBA-ja i jep përparësi marrëveshjeve ekonomike afatshkurta dhe zvogëlon fokusin në demokraci e sundim të ligjit, ekziston shqetësimi se kjo mund të krijojë hapësirë për më shumë përçarje dhe paqëndrueshmëri në rajon. Pas tri dekadash nga luftërat e viteve '90, ndryshimi i qasjes së ShBA-së dhe BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor mund të shënojë një fazë të re të konkurrencës për ndikim, me Kosovën, Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën në mesin e çështjeve më të ndjeshme.

Haradinaj paralajmëron protesta dhe bllokada: Do të jenë përgjigjja ndaj Kurtit

PRISHTINË, 14 GUSHT - Daut Haradinaj nga Aleanca ka folur për situatën e fundit politike në vend, bllokadën institucionale dhe mosvazhdimin e seancave plenare të Kuvendit. Haradinaj ka bërë me dije se ka nënshkruar një nismë për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa ka paralajmëruar se nëse situata vazhdon, opozita mund t'u drejtohet edhe protestave e bllokadave. "Na sa e nënshkruam një nismë nga një institut që kishte bërë thirrje për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese", ka deklaruar Haradinaj. Ai e ka akuzuar kryeministrin

në detyrë, Albin Kurti, se, sipas tij, synon që vendi të shkojë sërish në zgjedhje. "E kam thënë para tre muajsh, Kurti ka qëllim ripërsëritjen e zgjedhjeve derisa t'i ndodhë kjo popullit dhe ky ta vazhdojë avazin e njëjtë", është shprehur ai.

Haradinaj ka përdorur edhe gjuhë të ashpër ndaj Kurtit dhe Lëvizjes Vetëvendosje.

"Nuk do të thotë se krejt LV janë UDB-ash, por një fakt është se krejt UDB-ashat janë në LV", ka deklaruar ai.

Duke kritikuar qasjen e opozitës gjatë viteve të fundit, Haradinaj ka thënë se vetëm aktiviteti në rrjete sociale nuk



mjafton për ta larguar Kurtin nga pushteti. "Albin Kurti është frikacak dhe ky s'njeh gjuhë tjetër. Nëse opozita ka menduar

që gjashtë vjet që me 'Facebook' me largu z. Kurtin prej qeverisë, atëherë e ka pas shumë gabim", ka deklaruar Haradinaj.

Ai ka paralajmëruar se protestat dhe bllokadat mund të jenë hapi i radhës i opozitës. "Protesta, bllokada, do të jenë përgjigjja ndaj Kurtit", ka thënë Haradinaj për "Indeksonline". Haradinaj ka kritikuar Kurtin edhe për qëndrimet e tij ndaj shqiptarëve jashtë Kosovës dhe ndaj Shqipërisë, duke e akuzuar atë se është "antishqiptar" dhe "kundër Shqipërisë". Deklaratat e Haradinajt vijnë në një kohë kur Kuvendi vazhdon të përballet me bllokadë politike, ndërsa partitë opozitare kanë kërkuar zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për procesin e konstituimit të Kuvendit.

KURTI KËRKON MARRËVESHJE PËR PRESIDENTIN, OPOZITA E AKUZON PËR BLOKADË DHE SHKELJE TË KUSHTETUTËS

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka kërkuar nga partitë politike t'i nisin diskutimet për emrat konkretë të kandidatëve për president, me synim arrijen e një marrëveshjeje dhe shmangien e zgjedhjeve të reja. Ndërkohë, PDK-ja dhe AAK-ja kanë kërkuar vazhdimin e seancës konstituive, duke e akuzuar pushtetin për shkelje të Kushtetutës dhe krijim të vakuumit institucional. PDK-ja, përmes Bedri Hamzës, ka thënë se pas qëndrimit të LDK-së, LV-ja i ka numrat për konstituimin e Kuvendit. LDK-ja, ndërkaj, ka hequr dorë nga kërkesat për poste institucionale dhe ka kërkuar që presidenti i ardhshëm të jetë figurë jopartiake dhe konsensuale

**EPOKA E RE****Lirim GECI**

PRISHTINË, 14 GUSHT - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të premten se partitë politike duhet t'i fillojnë diskutimet edhe për emrat konkretë të kandidatëve për presidentin e ardhshëm, me qëllim që të arrihet një marrëveshje dhe të shmangen zgjedhjet e reja. "Duhet të fillojmë të flasim edhe me emra, sepse po humbim shumë kohë, por më së shumti humbim duke shkuar në zgjedhje", ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se presidenti i ardhshëm duhet të jetë "konsensual", gjithëpërfshirës dhe të ketë mbështetje sa më të gjerë në Kuvend dhe në mesin e qytetarëve. Kurti ka bërë me dije se u ka shkruar kryetarit të PDK-së, të LDK-së dhe të Aleancës, duke u kërkuar takim për të diskutuar për presidentin. "Duam që për këtë të merremi vesh paraprakisht në mënyrë që t'i evitojmë zgjedhjet", ka thënë ai.

Ai ka vlerësuar se në Kosovë ka "me dhjetëra" personalitete nga jeta akademike, politike dhe shoqërore, përfshirë persona që kanë kontribuar në luftë dhe në shtetndërtim, që mund të

konsiderohen për këtë pozitë.

Deklaratat e Kurtit vijnë një ditë pasi LDK-ja ka njoftuar se tërhiqet nga negociatat për poste me LV-në dhe se nuk kërkon asnjë pozitë institucionale, por do të votojë për një figurë jopartiake për president.

Hamza: Kurti, Haxhiu dhe Dehari qëllimisht shkelën Kushtetutën

Ndërkohë PDK-ja dhe AAK-ja kanë qëndruar edhe të premten në sallën e Kuvendit, duke kërkuar vazhdimin e seancës konstituive, ndonëse për sot nuk është thirrur seancë. Ato kanë kërkuar të vazhdojë seanca konstituive e Kuvendit, e cila ka mbetur e ndërprerë në kuadër të përpjekjeve për konstituimin e legjislaturës së re.

Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka deklaruar se kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, dhe kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari, kanë shkelur qëllimisht Kushtetutën e vendit. Sipas tij, situata politike tashmë ka kaluar në krizë kushtetuese dhe institucionale. "Jemi sot këtu së bashku me

deputetët tanë dhe deputetët e Aleancës sepse LV, Kurti, Haxhiu dhe Dehari e kanë kaluar një kufi që nuk është dashur ta kalojnë kurrë. Ata qëllimisht e kanë shkelur afatin kushtetues për konstituimin e Kuvendit dhe vendimin e fundit të Gjykatës Kushtetuese, jo një afat të vendosur nga PDK-ja, jo nga opozita, por nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Sot nuk kemi më vetëm kriza politike, por edhe kriza kushtetuese dhe institucionale. Institucionet po funksionojnë në një terren të pasigurt me shkelje kushtetuese, me shkelje të Rregullores së Kuvendit, ndërsa përgjegjësia politike po shtyhet nga një ditë politike. Kjo nuk është normale dhe nuk do lejojmë të bëhet normale", ka thënë Hamza nga foltorja e Kuvendit.

Hamza ka kërkuar që institucionet ta respektojnë Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, ndërsa ka bërë thirrje që seanca konstituive të vazhdojë dhe Kuvendi të funksionalizohet.

Ndërsa në një konferencë për medie, Hamza ka deklaruar se pas qëndrimit të fundit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lëvizja Vetëvendosje tashmë i ka numrat dhe votat e nevojshme për ta vazhduar

konstituimin e Kuvendit dhe krijimin e institucioneve të vendit.

Ai ka thënë se PDK-ja nuk e ka kontestuar rezultatin zgjedhor dhe se nga kjo parti nuk ka pengesë për krijimin e institucioneve. Ai ka thënë se përgjegjësia tashmë është te Vetëvendosje dhe kryetari i saj, Albin Kurti. "Ne si parti opozitare nuk e kemi kontestuar rezultatin zgjedhor, edhe pse kemi thënë me fakte që zgjedhjet kanë qenë të lira, por jo të ndershme, është abuzuar para publikut. Procesi zgjedhor, fshehtësia e votës, ka qenë e cenuar. E kemi pranuar rezultatin zgjedhor. Nuk ka pengesë prej neve, është e kundërta, ne po themi: ejani, të përfundojmë me rezultatin zgjedhor, krijoni institucionet, mbani premtimet, zgjidhni presidentin, dhe tash pas qëndrimit të fundit të LDK-së, numrat janë të qarta, i kanë numrat, i kanë votat", ka thënë ai.

Hamza ka thënë se tash është në dorën e Kurtit nëse do të krijojë institucionet apo do ta mbajë vendin në atë që e ka quajtur "vakuum institucional". "Lëvizja Vetëvendosje, zoti Kurti, e ka për obligim t'i bëjë institucionet", ka thënë Hamza.

I pyetur nëse PDK-ja do të qëndrojë në sallën e Kuvendit në rast se propozohet një emër konsensual për president, Hamza ka thënë se kjo parti do ta luajë rolin e saj si subjekt opozitar, duke përmendur kritikën, alternativat dhe përkrahjen për çështje që janë në interes të vendit. "Zoti Kurti nuk do bashkëpunim, nuk do partneritet. Do nënshtrim. Partia Demokratike e Kosovës, bazuar në të gjithë këto fakte, ka ardhur në qëndrimin e saj i cili është i qartë, është i drejtë, është zëri i faktit. Ne do ta luajmë rolin tonë në Kuvendin e Republikës së Kosovës si parti opozitare me kritika, me alternativa, po edhe me përkrahje për çështje të rëndësishme për interesin e vendit. Edhe për marrëveshjet financiare ndërkombëtare dhe për tema të tjera të cilat janë në dobi dhe në interes të Kosovës dhe qytetarëve të vendit", ka thënë ai.

Hamza e ka kritikuar Kurtin për mënyrën se si, sipas tij, po trajtohet procesi i konstituimit të institucioneve, duke thënë se vendi po përballet me shkelje të rendit kushtetues dhe mosrespektim të vendimeve gjyqësore. "Nuk ka situatë më serioze dhe nuk mund të ketë situatë më serioze sesa

A MUND TA ZHBLLOKOJË KUSHTETUESJA NGËRÇIN NË KUVEND?

PRISHTINË, 14 GUSHT - Sa herë që është bllokuar situata rreth krijimit të institucioneve të Kosovës gjatë vitit 2025, adresa për një rrugëdalje ka qenë Gjykata Kushtetuese. Për vetëm tetë muaj kjo gjykatë kishte nxjerrë katër aktgjykime lidhur me konstituimin e Kuvendit të Kosovës, me sqarime edhe për mënyrën se si duhej të zhvillohej seanca me vetëm katër pika të rendit të ditës. Një situatë e ngjashme po përsëritet edhe këtë vit, por mbetet pyetja nëse Kushtetuesja mund të japë zgjidhje edhe kësaj radhe.

Kuvendi nuk e ka përmbyllur procesin e konstituimit të nisur më 6 gusht, pasi kreu i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, kërkoi kohë shtesë për arrijen e një marrëveshjeje politike. Afati për përmbylljen e konstituimit ka përfunduar më 7 gusht, bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të 26 qershorit 2025. Në atë aktgjykim Gjykata kishte përcaktuar se Kuvendi duhet të konstituohet brenda 30 ditësh nga certifikimi i rezultatit të zgjedhjeve, por nuk kishte sqaruar pasojat juridike nëse ky afat nuk respektohet. Pikërisht për të sqaruar se çfarë ndodh kur Kuvendi nuk konstituohet brenda afatit, ish-presidentja Vjosa Osmani kishte dërguar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese në korrik të vitit 2025. Megjithatë, ajo e kishte tërhequr kërkesën pas disa ditësh,

pasi Radomir Llaban, të cilin Osmani e kishte cilësuar “rrezik për sigurinë kombëtare”, ishte caktuar gjyqtar raportues në këtë lëndë. Në njoftimin për medie të asaj kohe, Gjykata Kushtetuese kishte thënë se “është e drejtë e palëve para Gjykatës që të kërkojnë tërheqjen e kërkesave të parashtruara”, të cilat Gjykata i trajton bazuar në Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e saj të punës. Gjykata Kushtetuese nuk i është përgjigjur Radios Evropa e Lirë nëse e ka ende në shqyrtim këtë rast apo nëse ai është mbyllur. Megjithatë, Rregullorja e Punës së Gjykatës Kushtetuese parasheh se shqyrtimi i një kërkesë mund të vazhdojë edhe pas tërheqjes së saj nga palët, “kur këtë e kërkon interesi publik dhe/ose respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë”.

A mund ta zgjidhë situatën një aktgjykim për kërkesën e Osmanit?

Flamur Hyseni, profesor në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ka thënë për Radion Evropë e Lirë se nuk pret që një sqarim i radhës nga Gjykata ta zgjidhë ngërçin nëse mungon vullneti politik. Sipas tij, bllokadat politike nuk duhet të zgjidhen



duke e zhvendosur përgjegjësinë nga 120 deputetët te Gjykata Kushtetuese. “Gjykata mund të përcaktojë kufijtë kushtetues, por nuk mund ta zëvendësojë procesin politik”, është shprehur Hyseni. Ndërsa Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv në Institutin e Kosovës për Drejtësi, ka thënë për Radion Evropë e Lirë se Gjykata Kushtetuese nuk ka mundësi të japë një zgjidhje përfundimtare, përveçse t’ua rikujtojë deputetëve rolin dhe përgjegjësitë që kanë. “Gjykata Kushtetuese nuk mund as të caktojë obligime, apo të marrë vendime për ta shpërndarë Kuvendin nëse nuk është konstituuar brenda 30 ditëve, nëse kjo nuk parashihet në Kushtetutë”, ka pohuar Miftaraj. Hyseni ka sqaruar se problemi kryesor qëndron te fakti se

Kushtetuta nuk parasheh pasojë juridike në rast të tejkalimit të afatit 30-ditor për konstituimin e Kuvendit. Edhe ai ka vlerësuar se Gjykata nuk mund të shkruajë një normë të re kushtetuese për ta zgjidhur situatën aktuale. “Gjykata Kushtetuese mund ta interpretojë Kushtetutën, por nuk mund të krijojë përmes interpretimit një pasojë kushtetuese që teksti nuk e përmban”, ka thënë Hyseni. Miftaraj ka thënë se nuk mund të pritet një vendim arbitrar që u tregon deputetëve se si duhet të veprojnë, pasi, sipas tij, Kushtetuesja nuk mund të tejkalojë kompetencat e veta. “Vetëm nëse vendos të hartojë një nen të ri në Kushtetutë e Kosovës, përmes aktgjykimit, por që do të

dilte në kundërshtim me parimet e demokracisë parlamentare”, është shprehur ai.

Lëvizja Vetëvendosje, partia fituese e zgjedhjeve të parakohshme të 7 qershorit, ka kërkuar kohë për konsultime me subjektet e tjera politike, veçanërisht për çështjen e zgjedhjes së presidentit. Ministrja në detyrë e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka thënë se, nga këndvështrimi i LV-së, deputetët kanë kohë për konstituimin e Kuvendit deri më 6 shtator, duke llogaritur 30-ditëshin nga nisja e seancës më 6 gusht.

Partia Demokratike e Kosovës ka insistuar që konstituimi i Kuvendit të mos vonojë, duke argumentuar se obligimi kushtetues vazhdon të jetë në fuqi edhe pas skadimit të afatit 30-ditor. Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës, e vetmja parti që kishte pranuar të bisedonte me LV-në për një marrëveshje eventuale, ka kërkuar respektimin e afateve kushtetuese. Njësoj, edhe Aleanca ka bërë thirrje për vazhdimin e seancës konstitutive, duke fajësuar LV-në për bllokimin e procesit. Në këtë situatë, Gjykata Kushtetuese mund të jetë sërish adresa ku kërkohet interpretimi i dispozitave kushtetuese, por ekspertët theksojnë se ajo nuk mund ta zëvendësojë marrëveshjen politike dhe përgjegjësinë e deputetëve për funksionalizimin e institucioneve.

suspendimi i rendit kushtetues, se mosrespektimi i rregullores së punës së Kuvendit, se mosrespektimi i vendimeve të gjykatave duke përfshirë edhe vendimin e Gjykatës Supreme. Nuk mundesh me thënë në të njëjtën kohë edhe deputet, edhe ministër, edhe kryeministër. Asnjë pengesë në rrugën e drejtë të konstituimit të institucioneve nuk e ka pasur”, ka thënë ai.

Ramadani akuzon pushtetin për shmangie të përgjegjësi: Po e çojnë Kosovën drejt vakuumit institucional

Nga foltorja e Kuvendit të Kosovës, deputeti i Aleancës, Burim Ramadani, ka kërkuar nga Lëvizja Vetëvendosje t’i japë fund vakuumit institucional dhe të mundësojë funksionalizimin e legjislaturës së 11-të.

Ramadani ka thënë se është “totalisht e paimagjinueshme” që vakuumi institucional të mos konsiderohet si çështje e sigurisë kombëtare. “Ajo që e besoj dhe që e kemi shqetësim të gjithë është fakti se Kosova dhe Kuvendi duhet të jenë funksionalë. Për shembull, edhe kërcënimin me rrjedhjen e Ibër-Lepencit, sepse nuk ka kush e trajton. Edhe për çmimet e larta”, ka thënë Ramadani.

Ai ka theksuar se askush nuk po e konteston fitoren e Vetëvendosjes në zgjedhjet e qershorit por, sipas tij, është vetë

kryeministri në detyrë, Albin Kurti, që po e konteston situatën politike. “Askush nuk po ia konteston fitoren e qershorit. Bindja jonë është që ajo do të jetë fitorja e fundit. Nuk po i kontestojmë në asnjë gjë, është vetë Kurti që po konteston”, është shprehur ai.

Ramadani e ka akuzuar pushtetin se po shmang përgjegjësitë dhe ka paralajmëruar se Aleanca nuk do të lejojë që Kosova të mbetet në vakum institucional. “Gjithçka që po bëjnë është që po ikin nga përgjegjësitë. Këtë nuk do ta lejojmë. E kemi për obligim që të mos e lejojmë Kosovën të futet në vakum institucional”, ka deklaruar ai.

PDK-ja dhe Aleanca kanë qëndruar në Kuvend edhe gjatë ditëve të kaluara, duke kërkuar që puna e Kuvendit të vazhdojë, ndërsa përplasjet me deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje janë shoqëruar edhe me tensione në sallë.

Ndërsa Lëvizja Vetëvendosje ka insistuar se para vazhdimit të procedurave për konstituimin e Kuvendit duhet të arrihet një marrëveshje politike për zgjedhjen e presidentit të ardhshëm. Kriza institucionale në Kosovë po vazhdon prej përplasjes mbi mënyrën se si duhet të procedohet me konstituimin e Kuvendit dhe zgjedhjen e presidentit. Pas zgjedhjeve të 7 qershorit, LV-ja ka dalë partia e parë me 53 deputetë, PDK-ja me 22, LDK-ja me 18 dhe AAK-ja me shtatë. Zgjedhjet e qershorit janë

Abdixhiku: LDK-ja heq dorë nga çdo kërkesë, presidenti të jetë jopartiak

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se partia e tij heq dorë nga çdo kërkesë për postin e kryeparlamentarit, presidentit dhe pjesëmarrjes në qeveri, duke theksuar se Lëvizja Vetëvendosje mund t’i mbajë të gjitha postet. “Meqë LV-ja nuk po e konsideron se ka nevojë për LDK-në si partnere, atëherë nuk do ta ketë dekor as për pushtetin e saj. Ne do të qëndrojmë në opozitë dhe do ta ushtrojmë këtë përgjegjësi me dinjitet”, ka thënë Abdixhiku në një konferencë për medie pas takimit me grupin parlamentar të LDK-së. Megjithatë, Abdixhiku ka thënë se LDK-ja do të kontribuojë në çështjen e presidentit, duke theksuar se partia ka përcaktuar kushtet për kreun e ri të shtetit. Sipas tij, presidenti i ri duhet ta mbrojë Republikën dhe

kushtetutshmërinë. “Nga ky moment, LV-ja mund ta zgjedhë stabilitetin përmes një presidenti që e zgjedhim bashkërisht ose mund ta çojë vendin drejt një krize të re”, ka thënë ai, duke e akuzuar LV-në e Albin Kurtit se nuk po pranon një “kompromis minimal”. Ai ka thënë se LDK-ja do të jetë pjesë e zgjedhjes së presidentit, pasi nëse nuk merr pjesë në votim, vendi shkon në zgjedhje, ndërsa me 61 votat e LV-së “s’mund të zgjidhet” presidenti. “Ta zgjedhim një president që i shërben Republikës, jopartiak, e jo një president karate”, ka thënë ai, duke shtuar se propozimet partiake do të refuzohen. “Propozimet e njëanshme janë të refuzueshme”, ka thënë ai, duke shtuar se emri i presidentit të ri duhet të dalë pas diskutimeve të detajuara mes partive. LDK-ja ishte partia e vetme që

pranoi të negocionte me LV-në, fituesen e zgjedhjeve të qershorit. Por, edhe pas disa takimeve, Kurti dhe Abdixhiku nuk kanë arritur marrëveshje. Abdixhiku ka thënë se Kurti i kishte ofruar postin e zëvendëskryeministrit dhe tri ministri, por oferta nuk ishte pranuar, duke shtuar se LDK-ja kishte kërkuar postin e presidentit dhe pjesëmarrje në ekzekutiv. “Meqë LV-ja nuk po e konsideron se ka nevojë për LDK-në si partnere, atëherë nuk do ta ketë dekor as për pushtetin e saj”, ka thënë Abdixhiku. Ai ka kërkuar që Kuvendi të konstituohet pa vonesë dhe LV-ja ta formojë qeverinë e re të vendit. “Nga ky moment askush nuk ka arsye dhe as alibi që të vonojë konstituimin e Kuvendit, formimin e Qeverisë dhe nisjen e bisedimeve për presidentin”, ka thënë Abdixhiku.

shkaktuar pikërisht për çështjen e presidentit, pasi palët nuk kanë arritur konsensus, pasi Vjosa Osmani i ka përfunduar mandati pesëvjeçar në krye të shtetit në

prill. LV-ja e Kurtit ka fituar mandate të mjaftueshme për ta konstituuar Kuvendin dhe për të votuar qeverinë e re, duke llogaritur edhe në votat e partive të minoriteteve joshumicë.

Megjithatë, për zgjedhjen e presidentit nevojitet prania e 80 deputetëve në Kuvendin me 120 vende, në mënyrë që votimi për presidentin e Kosovës të jetë i vlefshëm.

SORENSEN: DIALOGU KOSOVË - SERBI NUK KA VDEKUR, KA DHËNË REZULTATE KONKRETE

PRISHTINË, 14 GUSHT - I dërguari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen, ka deklaruar se dialogu i Brukselit “nuk ka vdekur” dhe se, së fundmi, ka sjellë rezultate konkrete, përfshirë përparimin për personat e zhdukur dhe disa marrëveshje praktike. “Dialogu vazhdon dhe ka dhënë rezultate konkrete, përfshirë përparimin e fundit në lidhje me personat e zhdukur dhe marrëveshjet praktike që ndikojnë në jetën e qytetarëve”, ka deklaruar Sorensen për “Kosovapress”. Megjithatë, ai ka vlerësuar se zbatimi i Marrëveshjes së vitit 2023 dhe Aneksit të Ohrit mbetet i pamjaftueshëm. “Zbatimi i Marrëveshjes së vitit 2023 është ende i pamjaftueshëm. Të dyja palët duhet të përshpejtojnë përmbushjen e obligimeve të tyre. Nuk ka alternativë ndaj procesit të normalizimit”, ka thënë ai. Sorenseni ka theksuar se institucionet funksionale në

Kosovë e lehtësojnë zbatimin e marrëveshjeve, por obligimet e dialogut mbeten të vlefshme pavarësisht prej zhvillimeve politike. Ai ka përsëritur se Kosova dhe Serbia duhet ta zbatojnë plotësisht marrëveshjen e vitit 2023 dhe aneksin e Ohrit, përfshirë obligimet lidhur me vetëmenaxhimin e komunitetit serb. Sa i përket rolit të ShBA-së, Sorenseni ka thënë se dialogu udhëhiqet nga BE-ja, ndërsa ShBA-ja mbetet partnere e rëndësishme. “Shtetet e Bashkuara janë partner i rëndësishëm dhe koordinimi i ngushtë ndërmjet BE-së dhe ShBA-së e mbështet procesin e normalizimit”, ka thënë ai. Sipas tij, përgjegjësia për zbatimin e marrëveshjeve mbetet te Kosova dhe Serbia. “Partnerët e jashtëm mund ta lehtësojnë dhe mbështesin procesin, por vetë palët duhet t’i përmbushin obligimet e tyre”, ka theksuar Sorenseni.



KOSOVA AFRON AVIACIONIN ME STANDARDET EVROPIANE, AAC-ja DHE EASA-ja FORMALIZOJNË BASHKËPUNIMIN

PRISHTINË, 14 GUSHT - Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës (AAC) dhe Agjencia e Bashkimit Evropian për Sigurinë e Aviacionit (EASA) kanë formalizuar dy marrëveshje pune që synojnë forcimin e bashkëpunimit dhe përafrimin e aviacionit civil të Kosovës me standardet evropiane të sigurisë. Drejtori i AAC-së, Arjanit Islami, ka thënë se marrëveshjet lidhen me bashkëpunimin e përgjithshëm ndërmjet dy institucioneve si dhe me mbledhjen dhe shkëmbimin e informacioneve për sigurinë e avionëve në kuadër të programit të BE-së për inspektimet në platformë. Sipas Islamit, marrëveshjet mbështesin zbatimin gradual të legjislacionit të BE-së në fushën e aviacionit dhe mundësojnë pjesëmarrjen e ekspertëve të AAC-së në struktura konsultative dhe teknike të EASA-s. Ai ka theksuar se kjo do ta afrojë Kosovën me zhvillimet rregullatore evropiane dhe do t’u mundësojë ekspertëve të Kosovës të kontribuojnë në



proceset teknike. Në të njëjtën kohë, AAC-ja do t’i nënshtrohet monitorimit dhe inspektimeve të

standardizimit nga EASA-ja dhe do të ketë përgjegjësi për zbatimin efektiv të kërkesave evropiane të sigurisë dhe

adresimin e çdo mangësie të identifikuar. Ndërsa ministri në detyrë i Infrastruktursë dhe Transportit,

Dimal Basha, ka thënë se nënshkrimi i marrëveshjeve konfirmon avancimin e aviacionit civil të Kosovës drejt sistemit evropian. Ai ka theksuar rëndësinë e transportit ajror për lidhjen me diasporën, zhvillimin ekonomik dhe procesin e integritetit evropian. Basha ka deklaruar se rritja e transportit ajror dhe pjesëmarrja gjithnjë e më e madhe e kompanive evropiane në tregun e Kosovës duhet të shoqërohen me një autoritet rregullator profesional dhe funksional. Sipas tij, bashkëpunimi me EASA-n nënkupton jo vetëm mundësi të reja, por edhe përgjegjësi shtesë për AAC-në, ndërsa qeveria është e gatshme të adresojë pa vonesë çdo gjetje që mund të rezultojë nga vlerësimet dhe inspektimet. Marrëveshjet, të nënshkruara më 3 gusht nga drejtori ekzekutiv i EASA-s, Florian Guillermet, dhe të formalizuara nga AAC-ja, synojnë forcimin e sigurisë së aviacionit dhe përafrimin e mëtejshëm të Kosovës me standardet dhe mekanizmat evropianë.

MPB-ja ndryshon lokacionin për tërheqjen e dokumenteve të shtetësisë

Prishtinë, 14 gusht - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka njoftuar qytetarët e Kosovës se, nga e hëna, 17 gusht 2026, do të ndryshojë lokacionin i zyrës për pranimin e vendimeve për fitim, rifitim dhe humbje të shtetësisë me lirim. Zyra e re do të jetë në objektin e Agjencisë për Regjistrim Civil,

në katin e parë, në rrugën “Luan Haradinaj”. Ndryshimi është bërë me qëllim të ndarjes së kësaj zyre nga objekti i Divizionit për të Huaj dhe krijimit të hapësirave më të përshtatshme për qytetarët. “Me qëllim të ofrimit të shërbimeve më efikase, Ministria e Punëve të

Brendshme ka shtuar stafin mbështetës, që shërbimet të jenë më efikase dhe të zvogëlohen radhët e pritjes”, ka njoftuar MPB-ja. Me këtë rast, MPB-ja u ka bërë thirrje qytetarëve ta shfrytëzojnë edhe mundësinë e aplikimit online përmes platformës “E-Kosova”.



100 KADETË BËHEN PJESË E SHËRBIMIT KORREKTUES TË KOSOVËS

PRISHTINË, 14 GUSHT - 100 kadetë kanë përmbyllur me sukses përgatitjen profesionale dhe tani do t'i bashkohen Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK). Në ceremoninë e diplomimit ka marrë pjesë kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ministria në detyrë e Drejtësisë, Donika Gërvalla dhe drejtori i ShKK-së, Ismail Dibrani. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se të jesh zyrtar korrektues është përgjegjësi e madhe, e cila kërkon disiplinë, integritet dhe përkushtim për sigurinë, rendin dhe dinjitetin e personave të privuar nga liria. "Të jesh zyrtar korrektues është përgjegjësi e madhe e cila kërkon disiplinë, integritet dhe përkushtim për sigurinë, rendin dhe dinjitetin e personave të privuar nga liria. Republika e Kosovës ka nevojë për ju dhe pret shumë prej jush", ka thënë Kurti.

Ai ka bërë me dije se në tri vitet e fundit në Shërbimin Korrektues të Kosovës janë rekrutuar rreth 400 zyrtarë të rinj korrektues. "Në tri vitet e fundit në Shërbimin Korrektues të Kosovës janë rekrutuar rreth 400 zyrtarë të rinj korrektues. Ky është një investim i rëndësishëm në fuqizimin e kapaciteteve njerëzore dhe në ndërtimin e një shërbimi korrektues modern, profesional dhe stabil. Por, numrat nuk janë qëllim në vete. Pas çdo

rekrutimi qëndron një përgjegjësi, pas çdo uniforme qëndron një detyrë dhe pas çdo zyrtari qëndron besimi i qytetarëve dhe mbështetja e institucioneve", është shprehur Kurti.

Sipas tij, Shërbimi Korrektues i Kosovës po zhvillohet dhe po fiton vlerësimin e partnerëve ndërkombëtarë. "Kosova po zhvillon një shërbim korrektues i cili gjithnjë e më shumë po fiton vlerësimin dhe respektin e partnerëve ndërkombëtarë. Sot Shërbimi Korrektues i Kosovës është anëtar i organizatave ndërkombëtare si Organizata Evropiane e Burgjeve dhe Shërbimeve Korrektuese (EuroPris) dhe Asociacioni Ndërkombëtar i Korrektimit dhe Burgjeve (ICPA) dhe gjithnjë e më shumë po fiton besimin e të gjithë partnerëve anë e mbanë globit. Përvojat dhe praktikrat e tij po çmohen jo vetëm ndërkombëtarisht, por sidomos në rajon, ku gjithnjë e më shumë vende po i marrin ato si model për avancimin e shërbimeve të tyre korrektuese. Kjo na obligon neve bashkë të mbajmë standarde edhe më të larta", ka thënë Kurti.

Kurti u është drejtuar edhe zyrtarëve të rinj korrektues, duke theksuar rëndësinë e profesionalizmit, ligjshmërisë dhe dinjitetit në ushtrimin e detyrës. "Të dashur zyrtarë, nga sot ju përfaqësoni shtetin dhe



institucionet. Në çdo situatë duhet të veproni me profesionalizëm, ligjshmëri dhe dinjitet. Autoriteti juaj matet me drejtësinë dhe respektin që tregoni në punë. Shërbimi juaj korrigjon, pra është i drejtë. Por shërbimi juaj edhe përmirëson, pra është i dobishëm për shërbimin", ka deklaruar ai. Ndërsa ministria në detyrë e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka thënë se dinjiteti njerëzor duhet të respektohet në çdo rrethanë, duke theksuar rëndësinë e profesionalizmit të zyrtarëve korrektues. "Detyra juaj nuk është vetëm të ruani rendin, është të bëni të mundur që siguria, ligjshmëria dhe trajtimi njerëzor të bashkëjetojnë çdo ditë në institucionet tona korrektuese. Në të njëjtën kohë,

një sistem korrektues modern nuk mund të mjaftohet vetëm me ekzekutimin e dënimit. Ai duhet të krijojë kushte që një person, pas përfundimit të dënimit, të ketë mundësi reale për rehabilitim dhe rikthim në shoqëri. Dhe në këtë proces, roli juaj është i pazëvendësueshëm", ka thënë Gërvalla.

Ndërsa drejtori i ShKK-së, Ismail Dibrani, u ka bërë thirrje zyrtarëve të rinj që detyrën ta ushtrojnë me profesionalizëm, integritet dhe respekt për dinjitetin njerëzor, duke theksuar rëndësinë e tyre jo vetëm në garantimin e sigurisë dhe rendit, por edhe në proceset e rehabilitimit dhe riintegritet të të burgosurve. Dibrani ka thënë se kjo është

dita kur një ëndërr, një përpjekje dhe një angazhim i gjatë marrin formë. "Për ju, kjo është dita kur një ëndërr, një përpjekje dhe një angazhim i gjatë marrin formë. Por mbi të gjitha, kjo është dita kur ju bëni përsipër një përgjegjësi të madhe. Të jesh zyrtar korrektues nuk do të thotë të veshësh thjesht një uniformë. Do të thotë të mbash mbi vete besimin që institucionet e Republikës së Kosovës vendosin mbi ju", ka thënë Dibrani.

Ai ka theksuar se nga tani kadetët do të kenë përgjegjësinë për garantimin e sigurisë, rendit dhe disiplinës në institucionet korrektuese. "Nga dita e sotme, ju do të jeni ata që do të garantoni sigurinë, rendin dhe disiplinën në institucionet tona korrektuese. Por puna juaj do të jetë shumë më tepër se kaq. Ne kemi një mision më të gjerë. Ne duhet të garantojmë sigurinë, por njëkohësisht të krijojmë mundësi për rehabilitim, riintegrim dhe ndryshim. Sepse për çdo person që hyn në një institucion korrektues, duhet të ekzistojë mundësia që një ditë të kthehet në shoqëri si njeri i dobishëm për shoqërinë dhe i përgjegjshëm. Dhe në këtë proces, roli juaj është jashtëzakonisht i rëndësishëm", është shprehur ai, duke shtuar se profesionalizmi dhe respekti për dinjitetin njerëzor duhet të jenë pjesë e ushtrimit të detyrës.

PROKURORI KODRALIU: I DYSHUARI PRANOI SE ISHTE REKRUTUAR NGA BIA DHE KISHTE KONTAKTE TË VAZHDUESHME ME ZYRTARËT SERBË

PRISHTINË, 14 GUSHT - Gjykata Themelore në Prishtinë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Speciale për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit Fehim Sali, i cili dyshohet për spiunazh.

Prokurori i rastit, Bekim Kodraliu, ka deklaruar se nga provat e siguruar në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Agjencinë Kosovare për Inteligjencë (AKI), është vërtetuar dyshimi i bazuar se Sali ka qenë i rekrutuar nga Shërbimi Inteligjent Serb (BIA). "Sot Prokuroria Speciale ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit Fehim Sali. Nga provat që kemi siguruar nga Policia e



Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë edhe me Agjencinë Kosovare për Inteligjencë, kemi vërtetuar dyshimin e bazuar se i njëjti ka qenë i rekrutuar në Shërbimin Inteligjent Serb (BIA),

më konkretisht nga zyrtari i saj, Zheljko Matoviq, dhe se i njëjti ka ofruar informacione këtij shërbimi në dëm të interesave të shtetit tonë. Konsiderojmë se nga provat që kemi siguruar kemi vërtetuar

dyshimin e bazuar mirë. Me rastin e paraqitjes së kërkesës për caktimin e paraburgimit, i pandehuri edhe vetë ka deklaruar se ka qenë i rekrutuar dhe ka pasur kontakte të vazhdueshme me zyrtarë të BIA-s. Siç jeni të informuar, edhe dje kemi kryer një bastisje në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe kemi siguruar prova materiale, më konkretisht telefona dhe një shumë të caktuar parash, të cilat ne konsiderojmë se janë dobi pasurore e përfituar përmes kryerjes së veprës penale. Pas përfundimit të hetimeve, konsiderojmë se ndaj të njëjtit do të ngremë edhe aktakuzë për veprën penale për të cilën tashmë kemi vërtetuar dyshimin e

bazuar", ka thënë ai.

Prokurori Kodraliu ka thënë se Fehim Sali është duke u hetuar për më shumë se një vit mirëpo, për shkak të ndjeshmërisë së rastit, është shprehur se nuk mund të japë më shumë informacione. "I njëjti ka qenë duke u hetuar për më shumë se një vit. Ndaj tij kemi zbatuar masat e veçanta hetimore dhe, nga hetimet që kemi zhvilluar, i njëjti ka pasur kontakte të ndryshme me zyrtarë të tjerë vendorë dhe me autoritete të Serbisë. Për shkak të hetimit që jemi duke zhvilluar dhe ndjeshmërisë së rastit, kërkojmë mirëkuptim nga ju që në këtë fazë nuk mund të japim më shumë informacione", ka deklaruar Kodraliu.

Arrestohet gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prishtinë, dyshohet për keqpërdorim të detyrës

PRISHTINË, 14 GUSHT - Prokuroria Speciale e Kosovës, në bashkëpunim me Njësinë e Veçantë Hetimore të Policisë së Kosovës, ka zhvilluar një aksion hetimor që ka rezultuar me arrestimin e një gjyqtari të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me

inicialet A. G. Sipas Prokurorisë Speciale, gjyqtari dyshohet për veprën penale "Keqpërdorim i detyrës zyrtare".

Hetimet ndaj tij janë zhvilluar për disa muaj, gjatë të cilëve autoritetet kanë siguruar të dhëna dhe prova që, sipas Prokurorisë, krijojnë

dyshim të arsyeshëm për përfshirjen e tij në veprën penale. Për këtë arsye, është ndërmarrë masa e arrestimit. Prokuroria Speciale ka theksuar se, për shkak të respektimit të integritetit të hetimit dhe parimit të prezumimit të pafajësisë, nuk mund të bëhen

të ditura hollësi të tjera në këtë fazë. Prokuroria Speciale dhe Policia e Kosovës kanë deklaruar se mbeten të përkushtuara në luftimin e korrupsionit, keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe veprave të tjera penale, duke vepruar në përputhje me ligjin.



PËRMBARUESI BLOKON LLOGARITË E NPB-së, NDËRMARRJA PARALAJMËRON PASOJA TË RËNDA FINANCIARE

PRISHTINË, 14 GUSHT - Ndërmarrja Publike Banësore (NPB) Sh. A. ka njoftuar se llogaritë e saj bankare janë bllokuar në kuadër të një procedure përmbarimore që lidhet me kontestin gjyqësor për projektin në Lakrishtë, duke paralajmëruar pasoja të rënda për funksionimin e ndërmarrjes dhe interesin publik. Përmes një komunikate për medie, NPB-ja ka bërë me dije se kontesti buron nga një kontratë e lidhur më 17 maj 2021 nga administrata e kaluar, të cilën ndërmarrja e konsideron të dëmshme për interesin publik. Sipas NPB-së, më 24 qershor 2026 është ushtruar revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, përmes të cilit janë kundërshtuar vendimet e deritanishme gjyqësore dhe janë ngritur çështje që lidhen me

shkelje procedurale, zbatimin e gabuar të ligjit, përgjegjësinë e ndërmarrjes dhe llogaritjen e mbi 32 milionë eurove si fitim i humbur. Ndërmarrja ka shprehur bindjen se argumentet juridike dhe faktike të paraqitura në revizion do të rezultojnë me një vendim në favor të saj dhe të mbrojtjes së interesit publik. Megjithatë, NPB-ja ka theksuar se vetëm një ditë pas ushtrimit të revizionit është lëshuar urdhri përmbarimor, ndërsa procedura ka vijuar me ritëm të përshpejtuar deri në bllokimin e llogarive bankare. Sipas ndërmarrjes, bazuar në informacionet që ka, revizioni ende nuk është përcjellë nga Gjykata Komerciale në Gjykatën Supreme. NPB-ja ka ngritur pyetjen se pse procedura e përmbarimit



po zhvillohet me shpejtësi, ndërkohë që revizioni, i cili synon kontrollin e ligjshmërisë së vendimit, ende nuk ka mbërritur në instancën më të lartë gjyqësore. NPB-ja ka paralajmëruar se bllokimi i llogarive nuk prek

vetëm financat e ndërmarrjes, por rrezikon drejtpërdrejt pagat e mbi 300 punëtorëve, funksionimin e ndërmarrjes si pasuri publike, komunën e Prishtinës si aksionare si dhe shërbimet që u ofrohen qytetarëve.

Ndërmarrja ka njoftuar se do të vazhdojë t'i përdorë të gjitha mjetet juridike dhe institucionale në dispozicion, ndërsa ka kërkuar transparencë të plotë dhe trajtim urgjent të rastit nga institucionet kompetente. Po ashtu, NPB-ja i ka bërë thirrje Gjykatës Supreme të veprojë sa më shpejt në mbrojtje të interesit publik, duke paralajmëruar se në të kundërt pasojat për ndërmarrjen mund të jenë të paparashikueshme. Në fund, NPB-ja ka ftuar mediet, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet relevante që ta monitorojnë rastin dhe të kontribuojnë në mbrojtjen e pasurisë publike nga, siç është thënë në komunikatë, përfitimet shumë milionëshe të kompanive private.

AKB-ja: BLOKADA INSTITUCIONALE RRIT PASIGURINË PËR BIZNESET DHE DËMTON INVESTIMET NË KOSOVË

PRISHTINË, 14 GUSHT - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka shprehur shqetësim të thellë për krizën institucionale dhe përplasjet e fundit në Kuvendin e Kosovës ndërmjet mazhorancës dhe opozitës. Sipas AKB-së, moskonstituimi i Kuvendit, mungesa e dialogut politik dhe pamundësia për të gjetur një zgjidhje institucionale po e thellojnë krizën dhe po dëmtojnë besimin e qytetarëve, bizneseve dhe investitorëve në institucionet e Kosovës. "Partia fituese ka përgjegjësinë e parë për krijimin e institucioneve, ndërsa opozita ka përgjegjësinë demokratike të marrë pjesë në funksionimin e Kuvendit, të kontrollojë, kritikojë dhe votojë sipas mandatit të saj. Opozita nuk është e obliguar të hyjë në qeveri, por është e obliguar të ushtrojë mandatin e saj parlamentar", është thënë në reagimin e AKB-së, duke shtuar se çdo ditë e bllokimit institucional rrit pasigurinë për bizneset dhe investitorët. "Kur dialogu politik mungon, kur rregullat kushtetuese dhe parlamentare nuk respektohen dhe kur debati



politik kalon në përplasje fizike, atëherë cenohet vetë demokracia dhe funksionimi institucional i shtetit. Kuvendi është vendi i debatit, argumentit dhe votës, jo i konfrontimit fizik. Kosova nuk mund të mbahet peng nga inatet partiake. Institucionet nuk mund të funksionojnë pa dialog, ndërsa ekonomia nuk mund të presë. Çdo ditë e bllokimit institucional rrit pasigurinë për bizneset dhe investitorët, frenon vendimmarrjen ekonomike dhe dëmton imazhin e Kosovës si destinacion për investime", është thënë më tutje në reagimin e AKB-së. AKB-ja u ka bërë thirrje të gjitha partive politike që të ulen në dialog, ta respektojnë Kushtetutën dhe rregullat demokratike, ta konstitudojnë Kuvendin dhe të krijojnë institucione funksionale. "Kosova ka nevojë për vota, jo për përleshje; për dialog, jo për bllokadë; për institucione, jo për krizë të përhershme. Interesi i shtetit, qytetarëve dhe ekonomisë duhet të jetë mbi çdo interes partiak", është thënë në reagimin e AKB-së.

IKD-ja: Moskonstituimi i Kuvendit rrezikon 31.3 milionë euro nga Plani i Rritjes së BE-së

Prishtinë, 14 gusht - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka vlerësuar se moskonstituimi i Kuvendit rrezikon zbatimin e pesë hapave reformues në fushën 2 të Planit të Rritjes. Vlera e tyre arrin në 31.3 milionë euro, ose 18.87 për qind të fondeve të përgjithshme të planit të parapara deri në fund të vitit 2026. "Fusha 2 mbulon tranzicionin e gjelbër dhe digjital, me fokus në energji, politika klimatike dhe shërbime

publike digjitale. Hapat e paraparë përfshijnë ankandin për 150 MW energji nga era, përafrimin me Aktin për Infrastrukturën Gigabit dhe miratimin e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Po ashtu, kërkohet plotësimi i kornizës nënligjore për zbatimin e Ligjit për Ndryshimet Klimatike dhe thjeshtimi i procedurave për projektet e energjisë së ripërtëritshme. Zbatimi i shumicës së këtyre

hapave kërkon miratimin e legjislacionit dhe të akteve nënligjore, si dhe bashkërendimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Për këtë arsye, bllokada institucionale rrezikon drejtpërdrejt realizimin e tyre brenda afateve të përcaktuara", ka njoftuar IKD-ja. IKD-ja ka theksuar se Kuvendi mbetet jofunksional, ndërsa vazhdimi i bllokadës rrezikon përmbushjen e obligimeve të

Kosovës karshi BE-së. "Ndonëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se Kuvendi duhet të konstituhet brenda 30 ditëve nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve, ky afat nuk është respektuar. Kuvendi mbetet jofunksional, ndërsa formimi dhe funksionalizimi i institucioneve pas zgjedhjeve të 7 qershorit 2026 janë vënë në pikëpyetje. Vazhdimi i kësaj bllokade rrezikon përmbushjen e obligimeve të Kosovës dhe



disbursimin e mbi 31 milionë eurove nga kjo fushë. Njëkohësisht, dëmton besueshmërinë e vendit në procesin e reformave dhe të integritimit evropian", ka njoftuar IKD-ja.

PASTORI QË PA HIROSHIMËN DUKE U DJEGUR (DHE MENDONTE SE DUHEJ TË DIGJEJ)

Kujtimet e Kiyoshi Tanimotos rikujtojnë momentin tronditës kur ai pa hedhjen e bombës atomike, të cilën e konsideronte “gjykim të Zotit” mbi qytet.

Nga: Christopher Harding
(*The Telegraph*)

Në një mbrëmje, në maj të vitit 1955, publiku amerikan pa në televizion zhvillimin e një momenti të jashtëzakonshëm. Kiyoshi Tanimoto, një pastor i krishterë nga Hiroshima i cili kishte kaluar një dekadë duke punuar mes viktimave dhe rrënojave të lëna nga bomba atomike, u bë i nderuari i emisionit *This Is Your Life*. Në një skenë të rregulluar si dhomë ndenjeje në studiot e NBC-së në Los Anxhelos, Tanimoto - i cili ndodhej në ShBA për të mbledhur fonde për viktimat japoneze të luftës - e gjeti veten të ulur me drejtuesin e emisionit, Ralph Edwards, ndërsa buçisnin tingujt e regjistruar paraprakisht të trumbetave dhe një varg të ftuarish befasues kalonin përmes harkut të famshëm të emisionit.

I pari që u shfaq ishte misionari metodist i cili shumë vite më parë e kishte njohur Tanimoton me krishterimin. Më pas



Kiyoshi Tanimoto

erdhën grua ja dhe fëmijët e Tanimotos, të cilët kishin ardhur me aeroplan nga Japonia me pasaporta të rregulluara me ngut. Pastaj hyri një burrë për të cilin thuhej se kishte munguar në provën e programit dhe se ishte nxjerrë nga një bar pikërisht në kohë për paraqitjen e tij. Ai përpigëj, pa sukses, t'i përmbante lotët; shtrëngimi i dorës me Tanimoton, fytyra e të cilit mbeti e ngrirë, qe i shkurtër. Robert A. Lewis kishte qenë bashkëpiloti [i aeroplanit] Enola Gay.

Më shumë se 70 vjet më vonë, vajza e Tanimotos, Koko Kondo, e kujton këtë takim në parathënien e saj të Hiroshima, 8:15 - kujtimeve të humbura prej kohësh të babait të saj për bombardimin atomik. Libri jep në mënyrë intriguese një ide



Më 6 gusht 1945, ShBA-ja hodhi bombën atomike “Little Boy” mbi Hiroshimë - Foto: Universal History Archive via Getty Images

për ndërthurjen e pikëllimit dhe cinizmit që qëndroi në themel të rivendosjes së marrëdhënieve ShBA-Japoni pas luftës. Ai i çon lexuesit nga shkatërrimi dhe vuajtjet marramendëse që iu shkaktuan Japonisë - të dëshmuara nga Tanimoto - te pyetjet rreth domethënies morale dhe historike të asaj që bëri Amerika.

I lindur në vitin 1909 dhe i rritur si budist, Tanimoto u konvertua në krishterim kur ishte i ri. Studioi në Universitetin Emori në Shtetet e Bashkuara, zotëroi rrjedhshëm anglishten dhe u

njoh mirë me vlerat e krishtera amerikane. Pasi u kthye në Japoni dhe po punonte si pastor në Hiroshimë, ai ndodhej rreth dy milje jashtë qendrës së qytetit kur bomba atomike ra në orën 8:15 të mëngjesit, më 6 gusht 1945. Tanimoto kujton se vështroi horizontin dhe pa një “vezullim të mprehtë drite që çau një re të zbehtë ngjyrë kafe”. Teksa u hodh përtokë, ndjeu një shpërthim të fuqishëm ere që kaloi pranë tij. Distanca dhe topografia ia shpëtuan jetën. Pjerrësia e një kodre aty pranë bëri që pjesa më e rëndë e valës

së shpërthimit të kalonte mbi të.


Të gjithë kishin pritur një sulm ajror amerikan: shumë qytete japoneze ishin bombarduar gjatë muajve të fundit dhe Hiroshima ishte qendër e rëndësishme industriale. Por, ndërsa Tanimoto nisi të kthehej drejt Hiroshimës, u bë e qartë se diçka nuk ishte aspak në rregull. Shumica e njerëzve me të cilët foli nuk kishin parë asnjë aeroplan në qiell atë mëngjes, ose kishin parë vetëm një. E, megjithatë, në tokë dukej sikur çdo pjesë e qytetit ishte goditur

njëkohësisht dhe me një intensitet shkatërrues.

“A mos vallë kisha qenë duke ëndërruar më parë”, pyeste veten Tanimoto, “dhe nuk kisha ditur për një sulm të jashtëzakonshëm ajror që kishte goditur Hiroshimën? Fillova të vija në dyshim veten dhe madje të dyshoja në shqisat e mia ... I gjithë qyteti ishte mbuluar nga re të errëta, ndërsa zjarret e mëdha po shpërthenin në drejtime të ndryshme ... Isha tmerrësisht i frikësuar”.

Tanimoto nxitoi të shihte se çfarë kishte ndodhur me familjen dhe kishën e tij. Duke ardhur nga drejtimi i kundërt, hasi një kortezh të çuditshëm, makabër: njerëz që mezi ecnin, me rrobat dhe flokët djegur, të mbështetur në shkopinj ose te të afërmit, ndërsa arrinin të largoheshin ngadalë nga gjithçka që Tanimoto ishte gati të shihte. Lagje të tëra ishin zhdukur. Ushtarët ishin nëpër rrugë, duke derdhur gaz mbi pirgje trupash të pajetë dhe duke u vënë zjarrin. Ata që ishin ende gjallë thërrisnin për ujë dhe Tanimoto ndaloi të bënte çfarë mundej, përpara se të nxitonte më tej. Gjatë rrugës, gjeti gruan dhe vajzën e tij foshnjë. Të dyja kishin mbijetuar, megjithëse rrobat e së shoqes ishin të mbuluara me gjak dhe pamja e saj ishte “si e një fantazme”.

Shpejt, qytetarët e Hiroshimës e kuptuan se arma misterioze nuk e kishte përfunduar veprimin. Ajo e shndërroi



Një fotografi ajrore e Hiroshimës pak pasi u hodh bomba atomike “Little Boy” Foto: Universal History Archive/UiG via Getty Images

çështjen e mbijetesës në një pyetje që nuk kërkonte një çast për të marrë përgjigje, por javë, muaj, madje edhe vite. Njerëz të panumërt që atë ditë pësuan vetëm lëndime të lehta, më vonë panë se flokët po u binin, mishrat e dhëmbëve po u gjakosnin, gjymtyrët po u mpiheshin dhe në trup po u shfaqeshin njolla kuqezi - shenjat e asaj që më vonë u quajt “sëmundja atomike”.

Kujtimet e Tanimotos, të shkruara dy vjet më vonë, i rrëfenin të gjitha këto pa fraza të rëndomta apo pretendime letrare. Qoftë nëse kjo pasqyron personalitetin e tij, qoftë faktin se po shkruante në gjuhën e tij të dytë - anglishten - dhe jo në gjuhën e tij të parë, kjo është vetëm në të mirë të veprës. Disa çaste të historisë janë aq tronditëse, aq zemërthyes, saqë vetëm t’i përshkruash do të thotë t’i dënosh.

E, megjithatë, Tanimoto nuk i shmanget domethënies së asaj që i ndodhi qytetit dhe popullit të tij - përkundrazi. Në një nga pasazhet e tij më prekëse, ai madje argumenton se Hiroshima e kishte merituar atë që i ndodhi. Qyteti, vërente ai, ishte një “pikënisje për agresionin ushtarak kundër Koresë, Mançurisë dhe Kinës”. Në çdo rast të tillë, qyteti fitonte në mirëqenie. Ai u bë qytet i industrisë dhe arsimit, por ishte i dënuar me fatin me të cilin duhet të përballlet një qytet militarist. Hiroshima ishte e lidhur me vrasjet masive të kryera nga ushtria japoneze në Nanking, Kinë (1937), dhe Manila (1945). Ishte qytet i mallkuar. Dhe, këtu, Zoti kishte dhënë gjykimin e Tij. Asgjësimi i Hiroshimës dhe Nagasakit, sipas Tanimotos, ishte një pikë kthese. Transmetimi i dorëzimit nga



Një burrë i plagosur në Hiroshimë, pas sulmit me bombë atomikeFoto: Dukas/Getty Images

perandori më 15 gusht dhe humbja e autoritetit të tij politik sipas Kushtetutës së vitit 1947, e kishin përjashtuar atë si pikë qendrore për një Japoni të re. Ndërkohë, budizmi kishte rënë deri në atë pikë saqë shërbente thjesht si një shërbim funerali, i kontrolluar nga drejtues tempujsh që ishin më së shumti të interesuar t’u shërbenin klientëve të pasur. Përfundimi i Tanimotos, me të cilin disa prej arkitektëve të pushtimit aleat do të kishin qenë plotësisht dakord, ishte se Japonia duhej të përqaftonte demokracinë dhe krishterimin.

Rëndësia e Tanimotos si dëshmitar okular në Hiroshimë nuk mund të nënvlerësohet, ashtu si edhe rëndësia e tij si dikush që punoi pa u lodhur - ndonjëherë ndërsa ishte në prag të vdekjes nga rraskapitja dhe sëmundja - për t’u kujdesur për njerëzit dhe për të rindërtuar qytetin. Në javët e para pas bombardimit, ai luftoi zjarret, transportoi fqinjët

përtej një lumi drejt një vendi të sigurt dhe ofroi lutje e liturgji për të vdekurit. Më vonë, ai i ndihmoi njerëzit të orientoheshin në burokracinë e

rrënuar të Japonisë, ndërsa kërkonin pagesat e sigurimit nga zjarri dhe të sigurimit të jetës nga të cilat varej rindërtimi i jetës së tyre.



“Vajzat e Hiroshimës” u dërguan në ShBA për operacione për dëmtimet e shkaktuara nga bomba atomike - Foto: Bettmann




Pamje e pjesshme ajrore e rrënojave të Hiroshimës, disa ditë pas bombardimit atomik (gusht 1945)
Foto: Mondadori Portfolio/Getty Images

Por, Tanimoto ka rëndësi edhe për dritën që jeta e tij hedh mbi përpjekjet amerikane për të kuptuar atë që kishte bërë vendi i tyre. Hiroshima, 8:15 na jep një pjesë të kësaj, veçanërisht takimin e Tanimotos me gazetarin John Hersey, libri i të cilit, *Hiroshima* (1946), i hapi sytë botës ndaj shkatërrimit të qytetit dhe potencialit shkatërrues të armëve atomike. Por, mësojmë relativisht pak për kritikën me të cilat u përball Tanimoto në Japoni kur, për shembull, dërgoi në Amerikë 25 gra të shpërfytyruara nga bomba atomike, në mënyrë që ato t’i nënshtroheshin kirurgjisë rindërtuese.

“Vajzat e Hiroshimës”, siç njiheshin ato, morën një mbulim të gjerë mediatik, duke bërë që kjo nismë të dukej disi si një veprim publicitar që synonte të qetësonte ndërgjegjen e amerikanëve, ndërkohë që i kujtonte botës se ata shkëlqenin në teknologjitë e

pages po aq sa edhe në ato të luftës. Një hyrje që do të thellohej më shumë në jetën e Tanimotos mund t’u kishte dhënë lexuesve një perceptim më të plotë të kësaj figure të veçantë, por vazhdimisht të debatueshme.

Paraqitja e Tanimotos në *This Is Your Life* ndihmoi si në mbledhjen e fondeve për operacionet e “Vajzave”, ashtu edhe na kujton sot kotësinë e përpjekjes për t’i ndarë politikën, humanitarizmin dhe botën e spektaklit. Në pjesët e tij më të mira, ky libër i jashtëzakonshëm me kujtime, arrin t’i kapë këto marrëdhënie të mjegullta. Hibakushat e fundit të Japonisë - viktimat e bombave atomike - po i afrohen fundit të jetës së tyre, megjithatë bota nuk është aspak më pranë çarmatimit bërthamor për të cilin shumë prej tyre shpresuan dhe bënë fushatë. Tani, më shumë se kurrë, kemi nevojë për atë që na jep Tanimoto: një kujtesë të freskët dhe të gjallë të tragjediëve që këto armë u shkaktojnë të pafajshmëve. /Telegrafi/



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Felix Magath viziton FFK-në, takohet me Agim Ademin

PRISHTINË, 14 GUSHT - Trajneri i njohur gjerman Felix Magath ka vizituar Federatën e Futbollit të Kosovës (FFK). Ai është pritur në takim nga presidenti Agim Ademi, i cili ka bërë me dije se gjatë takimit e ka njoftuar Magathin për

zhvillimin e futbollit në Kosovë, përparimin e arritur ndër vite, investimet në infrastrukturë, zhvillimin e talentëve të rinj dhe synimet për ngritjen e mëtejshme të nivelit të futbollit të Kosovës.

Ademi dhe Magath kanë vizituar

edhe Kampin Nacional të FFK-së. Trajneri gjerman është njoftuar me kushtet dhe infrastrukturën e krijuar për zhvillimin e ekipeve kombëtare dhe gjeneratave të reja. Ademi e ka vlerësuar të veçantë mundësinë për të shkëmbyer

pikëpamje me Magathin, i cili ka lënë gjurmë në futbollin evropian si futbollist dhe trajner. Ai ka thënë se vizitat e personaliteteve të këtij niveli janë të mirëseardhura dhe e nderojnë FFK-në dhe futbollin e Kosovës.



DRITA SIGURON KUALIFIKIMIN NË "PLAY-OFF"-in E UEFA CONFERENCE LEAGUE

PRISHTINË, 14 GUSHT - FC Drita ka siguruar me meritë kualifikimin në "play-off"-in e UEFA Conference League, pas fitores së thellë 5:0 ndaj Tre Fiori nga San Marino, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

Kampionia e Kosovës kishte triumfuar edhe në ndeshjen e parë në San Marino me rezultat 4:1, ndërsa në duelin e kthimit konfirmoi epërsinë ndaj kundërshtarit, duke fituar bindshëm 5:0 dhe duke siguruar kalimin në fazën "play-off". Drita e ka mbyllur pjesën e parë me epërsi 3:0. Kemahlo Nguena ishte protagonist i kryesor, duke

shënuar dy gola. Mesfushori francez ka realizuar fillimisht në minutën e 20, pas asistimit të Vesel Limajt nga këndi, ndërsa në minutën e 41-të ka shënuar edhe për 2:0, pas asistimit të Raddy Ovoukës. Vetëm dy minuta më vonë Ovouka ka fituar një penallti, të cilën në gol e ka shndërruar Arb Manaj për 3:0.

Me fillimin e pjesës së dytë, Drita ka vazhduar dominimin dhe ka realizuar edhe golin e katërt. Për 4:0 ka shënuar zëvendësuesi Mike Arthur. Në minutën e 60 Arb Manaj ka realizuar edhe golin e dytë personal, duke vulosur fitoren



5:0 të skuadrës gjilanasë. Në këtë ndeshje, në bankinën e Dritës ka debutuar trajneri Ardian Nuhiu, i cili është rikthyer në krye të skuadrës gjilanasë. Në "play-off"-in kualifikues të UEFA Conference League, kampionia e Kosovës do të përballet me Inter d'Escaldes.

Ademi uron Dritën

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, e ka përgëzuar Dritën për kualifikimin në "play-off" të UEFA Conference League! "Kampionia e Kosovës, FC Drita, ka siguruar me plot meritë kalimin në "play-off"-in e UEFA Conference League, pas fitores së thellë 5:0 ndaj skuadrës nga San Marino, Tre Fiori, në stadiumin "Fadil Vokrri". Pas fitores 4:1 në ndeshjen e parë, gjilanasit konfirmuan edhe në ndeshjen e kthimit forcën dhe cilësinë e tyre ndaj rivalit, duke triumfuar bindshëm

5:0 dhe duke siguruar vendin në fazën e "play-off"-it të kësaj gare. Drita zhvilloi një paraqitje të shkëlqyer, duke e mbyllur pjesën e parë me epërsi 3:0, ndërsa në pjesën e dytë shënoi edhe dy herë të tjera për ta vulosur fitoren më bindëse në garat evropiane. Përgëzime futbollistëve, stafit teknik, drejtuesve të klubit dhe tifozëve "Intelektualët" për këtë sukses të rëndësishëm, që i sjell nder futbollit të Kosovës në arenën evropiane. FC Dritës i urojmë shumë suksese në "play-off" ndaj Inter d'Escaldes dhe një tjetër përfaqësim dinjitoz të futbollit të Kosovës!", është thënë në urimin e Ademit.

XHUDISTËT E KOSOVËS SYNOJNË SUKSESET E RADHËS, NISIN PËRGATITJET INTENSIVE NË HOLANDË

Papendal, 14 gusht - Ekipi i Kosovës në xhudo ka zhvilluar një javë përgatitjesh intensive në Kampin Olimpik Stërvitor në Papendal të Holandës, një prej qendrave më të njohura të sportit elitë në Evropë. Në këtë kamp janë mbledhur xhudistë nga vende të ndryshme të botës, ndërsa pjesë e tij ka qenë edhe ekipi nga Kosova i cili po vazhdon përgatitjet për garat e ardhshme ndërkombëtare. Kosova në Papendal është përfaqësuar nga Laura Fazliu, Flaka Loxha, Fatjona Kasapi,



Erza Muminoviq, Laurinë Gashi, Enise Zijade, Akil Gjakova, Dardan Cena dhe Shpati Zekaj. Ekipi i Kosovës është udhëhequr nga kryemjeshtri Driton Kuka dhe trajnerja Majlinda Kelmendi, të

cilët po punojnë me xhudistët në kuadër të përgatitjeve për sfidat e ardhshme. Kampi në Papendal paraqet një mundësi të rëndësishme për sportistët e Kosovës që ta matin nivelin e tyre me xhudistët më të mirë ndërkombëtarë dhe ta përmirësojnë formën para garave të radhës. Synimi i ekipit nga Kosova është që këto përgatitje t'i shërbejnë rrugëtimit drejt objektivave të mëdha, përfshirë Lojërat Olimpikë "Los Angeles 2028".

SINT-TRUIDENI BLEN PËRFUNDIMISHT ARBNOR MUJËN NGA SAMSUNSPORI

Bruksel, 14 gusht - Klubi belg Sint-Truiden ka konfirmuar zyrtarisht transferimin përfundimtar të sulmuesit anësor shqiptar, Arbnor Muja, nga Samsunspor. Pas një huazimi njëvjeçar, klubi belg ka vendosur ta blejë përfundimisht kartonin e Mujës, i cili gjatë sezonit të kaluar u paraqit në 28 ndeshje në të gjitha garat, duke shënuar gjashtë gola dhe duke dhuruar dy asistime. Paraqitjet e tij kanë bindur drejtuesit e Sint-Truiden për ta bërë marrëveshjen të përhershme. Klubi belg ka bërë të ditur gjithashtu se Muja do ta mbajë fanellën me numrin 7. "STVV blen përgjithmonë Arbnor



Mujën nga Samsunspor", ka njoftuar klubi përmes faqes zyrtare.

Muja gjatë karrierës së tij ka luajtur edhe për Trepçën, Trepçën '89, Skënderbeun, Dritën dhe Royal Antwerpen, para transferimit te Samsunspor.

Haaland pranon katër certifikata të rekordeve "Guinness"

MANCHESTER, 14 GUSHT - Sulmuesi i Manchester Cityt, Erling Haaland, ka marrë katër certifikata të Rekordeve Botërore "Guinness" për arritjet e tij në shënimin e golave.

26-vjeçari norvegjez është vlerësuar për rekordet e vendosura në Ligën Premierë, Ligën e Kampionëve dhe Ligën e Kombeve. Haaland është lojtari

më i shpejtë që ka arritur 100 gola në Ligën Premierë, duke e bërë këtë në vetëm 111 ndeshje. Rekordi u konfirmua më 2 dhjetor 2025, kur ai shënoi ndaj Fulhamit. Ai mban gjithashtu rekordin për më shumë gola të shënuar në një sezon të vetëm të Ligës Premierë. Në sezonin 2022/23, Haaland realizoi 36 gola, duke kaluar rekordin e

mëparshëm prej 34 golash, të mbajtur nga Andy Cole dhe Alan Shearer. Certifikata e tretë lidhet me Ligën e Kombeve, ku Haaland është golashënuesi më i mirë në historinë e garës me 19 gola të shënuar ndërmjet shtatorit 2020 dhe nëntorit 2024. Certifikata e katërt e njeh për barazimin e rekordit të Ligës së Kampionëve

për më shumë gola në një ndeshje. Haaland shënoi pesë gola ndaj RB Leipzig më 14 mars 2023, duke iu bashkuar Lionel Messit dhe Luiz Adrianos si lojtarët e vetëm që e kanë arritur këtë. Në pak më shumë se tre vjet në futbollin anglez, Haaland është shndërruar në një nga sulmuesit më dominues statistikisht. Tani ai synon ta



vazhdojë suksesin me Manchester Cityn, i cili këtë sezon do ta kërkojë rikthimin te titulli i Ligës Premierë.



NDËRMARRJA
PUBLIKE
BANESORE

Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 26 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Banesore si dhe Nenit 9, 10 dhe 11 të Rregullores mbi dhënien me qira të pasurive komerciale të Ndërmarrjes Publike Banesore, SH.A. Prishtinë, Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. Prishtinë shpallë:

FTESE PËR APLIKIM PËR MARRJE TË PRONAVE ME QIRA

Ftoheni që të aplikoni për marrje në shfrytëzim me qira të lokaleve afariste, depove dhe garazhave pronë e Ndërmarrjes Publike Banesore, SH.A. Prishtinë. Pronat e poshtë shënuara ipen në shfytëzim me qira personave juridik, përveç garazhave të cilat mund t'u ipen në shfrytëzim edhe personave fizik.

Pasuritë komerciale të cilat ipen me qira:

N r.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi €/m2 (pa TVSH)
1	Lokali 2/6a, rr."Lidhja e Prizrenit" (Afer tregut të gjelbert)	15.24m2	11
2	Lokali 2/14 rr."Lidhja e Prizrenit" (Afer tregut të gjelbert)	17.28m2	10
3	Lokali 6/29 rr."Adrian Krasniqi" (Tek ambasada e Zvicrres)	21.95m2	10
4	Lokali 6/36 rr."Adrian Krasniqi" (Tek ambasada e Zvicrres)	13.92m2	10
5	Garazha 15/1 rr."Xhavit Mitrovica" (Afer parkut të qytetit)	13.37m2	2
6	Lokali 15/8 rr."Xhavit Mitrovica" (Afer parkut të qytetit)	19.62m2	4
7	Lokali 15/9 rr."Xhavit Mitrovica" (Afer parkut të qytetit)	17.50m2	4
8	Lokali 15/10 rr."Xhavit Mitrovica" (Afer parkut të qytetit)	16.73	4
9	Lokali 18/5 lgj."Dardania" (Përball shkollës "Xhemajl Mustafa)	61.65m2	8
10	Garazha 20/19 Lgj."Ulpiana" (afër soliterave në "Ulpianë")	12.00m2	2
11	Lokali 22/30 rr."Agim Ramadani" (Mbrapa galerisë së arteve)	Lokal 130.17m2 Depo 157.95m2	Lokal 10 Depo 5
12	Lokali 22/96 rr."Agim Ramadani" (Mbrapa galerisë së arteve)	20.44	8
13	Lokali 22/98 rr."Agim Ramadani" (Mbrapa galerisë së arteve)	21.44m2	8
14	Lokali 22/102 rr."Agim Ramadani" (Mbrapa galerisë së arteve)	Lokal 83.66m2 Depo 100.42m2	Lokal 10 Depo 5
15	Lokali 22/108 rr."Agim Ramadani" (Mbrapa galerisë së arteve)	9.06m2	9
16	Lokali 22/110 rr."Agim Ramadani" (Mbrapa galerisë së arteve)	16.02	9
17	Lokali nr.13,lgj."Pejton"	33.3	7

Përveç çmimit bazë, qiramarrësi do të paguaj TVSH-në, shërbimet e mirëmbajtjes dhe obligimet komunale.

Periodha e Qiradhënies është minimum 2 vite, me mundësi vazhdimi.

Qiramarrësi është i obliguar që para nënshkrimit të kontratës me qiradhënësin, të bëjë sigurimin e kontratës së qirasë për tre muaj më gjatë se vetë kontrata, në shumë prej katër qirave mujore neto.

Parametrat që do të shërbejnë për përzgjedhjen e aplikuesëve:

- Lloji i veprimtarisë më të volitshëm;
- Sektori investues;

- Numri i të punësuarve nga investimi;
- Plani/ Përshkrimi i Biznesit;
- Kohëzgjatja e veprimtarisë së biznesit;
- Vendi i veprimtarisë së biznesit;

Aplikuesi duhet t'i dorëzoj këto dokumenta:

- Aplikacionin për marrjen e pasurive komerciale me qira (mund ta merrni në hapësirat e NPB-së);
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të të shoqërisë tregtare apo biznesit individual pranë ARBK-aë.
- Kopjen e certifikatës së TVSH-së nëse biznesi është deklarues i TVSH-së;
- Kopjen e certifikatës Fiskale;
- Numrin e xhirollogarisë bankare të biznesit apo pronarit të biznesit të nënshkruar dhe vulosur nga banka.
- Plani/ Përshkrimi i Biznesit;
- Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit ligjor të biznesit;
- Çertifikatën e solvencës së biznesit të lëshuar nga Gjykata jo më të vjetër se 6 muaj.
- Vërtetimin nga ATK-ja për pagesën e obligimeve tatimore, (personi duhet të jetë i regjistruar në ATK dhe të mos ketë borxhe tatimore);
- Fletëpagesën për aplikim.

Për aplikuesit të cilët aplikojnë për marrjen në shfrytëzim me qira të garazhave duhet që ti sjellin dokumentat sipas pikave: 1, 5, 7, 10.

Aplikacioni duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur. Në zarf (jashtë) duhet të specifikohet: emri i aplikuesit, nr. intern i patundshmërisë dhe kontaktet e aplikuesit (emaili dhe numer të telefonit).

irifa e aplikimit: 10 € (Euro). Kont: BPB: 130 000 150 000 886 4. BKT: 190 946 698 103 119 NLB: 170 020 000 000 035 1.

Aplikacionet nuk do të merren parasysh nëse:

- Aplikuesi tashmë e ka një pasuri komerciale me qira nga Ndërmarrja Publike Banesore SH.A.Prishtinë.
- Aplikuesi ka pasur një pasuri komerciale me qira nga Ndërmarrja Publike Banesore dhe nuk i është përmbajtur kontratës së qirasë ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes.
- Nëse aplikohet për bizneset veprimtaria e të cilave është e ndaluar me ligj në hapësirat përkatëse;
- Nëse aplikacioni nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara.
- Nëse aplikacioni arrinë pas datës së skadimit të afatit të publikimit të shpalljes.

Personat të cilët duan t'i vizitojnë lokalet me praninë e zyrtarëve të NPB-së, si dhe të kenë qasje në hapësirat e brendshme të tyre, këtë mund ta bëjnë me datën dhe orarin si në vijim:

Numri i lokalit (sipas renditjes në tabelë)	Data	Periodha kohore
1, 2, 3, 4	19.08.2026	09:00 – 11:00
5, 6, 7, 8, 9, 10, 11	19.08.2026	13:00 – 15:00
12, 13, 14, 15, 16,17	20.08.2026	09:00 – 11:00

Afati për aplikim është i hapur nga data 14.08.2026 deri më date 28.08.2026.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: Ndërmarrja Publike Banesore-SH.A. në Prishtinë, rruga "Zija Shemsiu" nr. 22, lagja, "Ulpiana" - Prishtinë.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ESAS danisman” L.L.C. pronar Elif Seyhan Yonden me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812302397 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ESAS danisman” L.L.C. Elif Seyhan Yonden Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812302397 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “ESAS danisman” L.L.C. with owner Elif Seyhan Yonden with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812302397 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Hak Bau” SH.P.K. nga Gjakova bënë rritjen e kapitalit të SH.P.K me numër Unik Identifikues 812452382 të lëshuar nga ARBK.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

